

VENDIM
Nr. 786, datë 14.11.2012

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM NGA MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRISË SË BRENDSHME, TË OBJEKTIT NR. 36, ME EMËRTIMIN “ISH-KOLEGJI
TURK”, DHE TË TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 12, ME EMËRTIMIN
“KOMANDA E DOKTRINAVE DHE STËRVITJES”, TIRANË, ME SIPËRFAQEN E
PËRGJITHSHME 7594 M², PËR SHKOLLËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe të neneve 10 e 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Brendshme, të objektit nr. 36, me sipërfaqen ndërtimore 870.87 (tetëqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e shtatë) m², me emërtimin “Ish-Kolegji Turk”, dhe truallin funksional, gjithsej 7594 (shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) m², pjesë e pronës nr. 12, me emërtimin “Komanda e Doktrinave dhe Stërvitjes”, Tiranë, për një periudhë 40-vjeçare, sipas planvendosjes dhe planimetrive, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ta përdorur për Shkollën e Administratës Publike Shqiptare.

2. Ministrisë së Brendshme i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

Në rastin e përfundimit të veprimtarisë dhe aktivitetit të Shkollës së Administratës Publike Shqiptare, para afatit të përcaktuar në këtë vendim, objekti dhe trualli funksional t’i kthehen Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mbrojtjes dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha